

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA MINISTRIA E ARSIMIT DHE E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARCHIVE-ARCHIVE SECTOR	
Njësia Org. Org. Jedinica Org Unit	Nr. Prot: Broj Prot: 3219
Nr. i faqeve Br. stranica No. pages	Data: Datum: 19/11/20 20
Prishtinë / a	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Arsimit dhe Shkencës / Ministarstvo Obrazovanja i Nauke / Ministry of Education and Science

Kabineti i Ministrit/Kabinet Ministra/Cabinet of the Minister

Numër: 01B-134
Datë: 19.11.2020

Ministri i Arsimit dhe Shkencës, në mbështetje të neneve 8, 10 dhe 11 të Ligjit nr 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta zyrtare, nr. 7/01 mars 2019), në bazë të neneve 6 dhe 29 të Ligjit për Arsimin e Lartë të Republikës së Kosovës, nenit 8 paragrafi 1.4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), si dhe në bazë të kërkesës së aplikuesve të Fakultetit të Mjekësisë së Përgjithshme të Universitetit “Hasan Prishtina” me nr. prot. 5909 të datës 13.10.2020, nxjerr:

VENDIM

1. Miratohet kërkesa e aplikuesve të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” për rritjen e numrit të studentëve të rinj për vitin akademik 2020-2021, në nivelin Baçelor, në degën:
 - 1.1. Mjekësi e përgjithshme, prej 150 studentë sa ka aktualisht, të rritet numri deri në 50 të rinj, varësisht prej kapaciteteve që ka Fakulteti i Mjekësisë të Universitetit “Hasan Prishtina”.
2. Vendimi hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

Arsyetim

Duke u mbështetur në dispozitat të cekura më lartë, në bazë të kërkesës së aplikuesve të Fakultetit të Mjekësisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina” me nr. prot. 5909 të datës 13.10.2020 për rritjen e numrit të studentëve të rinj për praninë në degën e Mjekësisë së Përgjithshme, rritet deri në 50 studentë të rinj, e cila është bazuar në faktin se brenda numrit të shpallur në konkurs janë përfshirë 17% të kuotave për komunitetin joshumicë dhe për kandidatët nga trojet tjera shqiptare jashtë Republikës së Kosovës. Duke u bazuar në

kërkesën e Ministrisë së Shëndetësisë të datës 13.11.2020 po ashtu edhe kërkesën e Komisionit parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport dhe pas konsultimeve me AKA-në dhe KSHC-në për rritjen e numrit të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, për vitin akademik 2020/2021 dhe nevojën afatgjate për plotësimin e kërkesave të Republikës së Kosovës për profesionistë shëndetësorë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

1. Kabinetit të Ministrit/MASH;
2. Zyrës së SP/MASH;
3. DAL/MASH;
4. Universitetit të Prishtinës
5. Arkivit.

Ramë Likaj, ministër



Rrahim Ferati

From: Beqir Kiqina
Sent: 19 November 2020 12:13
To: Rrahim Ferati
Subject: FW: Kërkesë nga studentët për rritje të numërit në Drejtimin e Mjekësisë.

From: Valentina Bunjaku Rexhepi
Sent: Wednesday, November 18, 2020 12:00 PM
To: Rame Likaj
Cc: Beqir Kiqina
Subject: Kërkesë nga studentët për rritje të numërit në Drejtimin e Mjekësisë.

I nderuar Ministër Dr. Sc. Ramë Likaj,

Ju informojmë se në adresë të Komisionit parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, kemi pranuar disa kërkesa nga aplikantët që kanë aplikuar për regjistrim në Fakultetin e Mjekësisë, përkatësisht në drejtimin Mjekësi e Përgjithshme dhe në drejtimin e Stomatologjisë.

Komisioni për Arsim në mbledhjen e mbajtur më datë 03.11.2020, ka shqyrtuar kërkesat e aplikantëve të lartcekur dhe luteni që t'a shqyrtoni me kujdesë këtë çështje pasi që neve si komision na u kan adresuar shumë kërkesa në lidhje me mundësimin e rritjes së numrit në drejtimin e mjekësisë.

Komisioni e vlerëson si të arsyeshme kërkesën e aplikantëve me arsyetimin për rritjen kuotave sikurse ka ndodhur vitin e kaluar, andaj lutem organet kompetente që mundësisht ta trajtonë kërkesën e aplikantëve për studime në Fakultetin e Mjekësisë bazuar në legjislacionin në fuqi.

Me respekt,

Valentina Bunjaku-Rexhepi
Kryetare e Komisionit për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport

Kuvendi i Republikës së Kosovës

Tel.038 / 200 10 135

Cel. +383 44 177 234

Email: valentina.bunjakurexhepi@assembly-kosova.org Zyra/Office – S 204

REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E ARSIMIT E SHKENCËS DHE E TEKNOLOGJISË
 MINISTARSTVO OBRAZOVANJA NAUKE I TEHNOLOGIJE
 MINISTRY OF EDUCATION SCIENCE & TECHNOLOGY
 SEKTORI I ARKIVËS-SEKTOR ARHIVE-ARCHIVE SECTOR

Njesia Org. 01/B
 Org. Jedinica
 Org Unit
 Nr. i faqeve
 Br. stranica
 No. pages

Nr. Prot. 3147
 Broj Prot.
 Prot. No.
 Data:
 Datum: 16/11/20
 Date:

Prishtinë / a



REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVA
 QEVERIA E KOSOVËS-VLADA KOSOVA-GOVERNMENT OF KOSOVA
 MINISTRIA E SHËNDETËSISË-MINISTARSTVO ZDRAVLJA-MINISTRY OF HEALTH

Njesia Org.
 Org. Jedinica
 Org Unit

Nr. Prot.
 Broj Prot.
 Prot. No. 05-7614

Nr. i faqeve
 Br. stranica
 No. pages -2-

Data:
 Datum: 13/11/20
 Date:

Prishtinë / a

Republika e Kosovës
 Republika Kosova-Republic of Kosovo
 Qeveria -Vlada-Government
 Ministria Shëndetësisë-Ministarstva Zdravstva- Ministry of Health
 Zyra e Ministrit/Ured Ministra/Office of the Minister

DATË/A:	13.11.2020
PËR/ZA/TO:	Z. Ramë Likaj, Ministër i Arsimit dhe Shkencës, Z. Ujkan Bajra, Kryetar i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës, Z. Naser Sahiti, Rektorit Universitetit të Prishtinës, Znj. Suzana Manxhuka Kërliu, Dekane e Fakultetit të Mjekësisë.
NGA/OD/FROM:	Z. Armend Zemaj, Ministër i Shëndetësisë.
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Rritja e numrit të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, në vitin akademik 2020/2021.

Të nderuar/a,

Ministria e Shëndetësisë, është e angazhuar që të krijoj një sistem shëndetësor cilësor dhe me standarde europiane i cili ofron shërbime moderne dhe adekuate, përmes reformave në shëndetësi, ngritjen e kapaciteteve humane në Kosovë dhe specializimeve në fusha të ndryshme në shëndetësi.

Gjatë analizës së gjendjes së numrit të profesionistëve shëndetësor, konform nevojave dhe standardeve për të arritur një nivel të tillë strategjik dhe funksional, në vendin tonë ka mungesë të profesionistëve shëndetësor të të gjitha lëmive dhe numri i tyre është nën standardet europiane si dhe në nivelin më të ulët në krahasim me vendet në rajon.

Andaj, për të realizuar planin tonë për shërbime cilësore dhe adekuate, kërkojmë nga ju me mirëkuptim, si vijon:

Krijoni kapacitete për rritjen e numrit të studentëve të lëmive shëndetësore në funksion të rritjes së numrit të profesionistëve shëndetësor të të gjitha fushave mjekësore dhe mbështetëse, për vitin akademik 2020/2021.

Kjo rritje do të mundësonte:

1. Rritjen e shërbimeve shëndetësore adekuate dhe profesionale,
2. Zëvendësimin e profesionistëve shëndetësor të moshuar dhe të pensionuar,
3. Plotësimin e mungesave të krijuara nga ikja e profesionistëve nga vendi,
4. Mundësimin e zhvillimit dhe qëndrimit të tyre në vend, përmes krijimit të kushteve të bërë tanimë nga Ministria e Shëndetësisë me dhënien e specializimeve për të gjithë profesionistët.

Rritja e numrit të studentëve të Fakultetit të Mjekësisë, është interes nacional, andaj pres që ky adresim të merret në konsideratë.

Ju faleminderit për mbështetje dhe mirëkuptim!

Me nderime,
Armend Zemaj

